



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Qershor 2021

Nr. 418

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dega Sarandë
- Kërkues:** Lëvizja Socialiste për Integrim
- Ndaj:** Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dega Sarandë
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak



Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të raportuar më datë 24.04.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 3312, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dega Sarandë, më datë 24.04.2021, 1 (një) ditë para ditës së zgjedhjeve, kanë bërë të mundur shpërndarjen e certifikatave, lejeve të legalizimit apo akteve të tjera shtetërore.”*

Sipas denoncuesit: *“Ky veprim është në kundërshtim me vendimin nr. 9, neni 3, pika 1.3, shkronja “a”, “b”, dhe “ç”, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ”.*

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit janë paraqitur si mjet provues disa pamje në formatin video.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a njeh shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për



raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në kallëzimin e datës 24.04.2021, me nr. 3312 ID, pretendohet se shpërndarja e certifikatave, lejeve të legalizimit apo akteve të tjera shtetërore, nga ASHK dega Sarandë, është në kundërshtim me nenin 3, pika 1.3, shkronjat “a”, “b”, dhe “ç”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 1.3, shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon se, “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

- a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;
- b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, dhe cfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;
- ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Lidhur me rastin objekt kallëzimi, kallëzuesi pretendon se ASHK dega Sarandë, 1 (një) ditë para ditës së zgjedhjeve, ka bërë të mundur shpërndarjen e certifikatave, lejeve të legalizimit apo akteve të tjera shtetërore.

Referuar vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, ajo që ky vendim ndalon është kryerja e saj përgjatë veprimtarive publike në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Shpërndarja e lejeve të legalizimit është veprimtari rutinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila nuk ndërpritet për shkak të periudhës zgjedhore.

“Veprimtari publike”, në kuptimin e pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe të shkronjës “b” të nenit 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut rreth tyre, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

Nga provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi e provuar që kryerja e veprimtarisë të jetë bërë në vende të hapura për publikun, në sheshe ose në njësitë e shërbimeve komunitare të zonës. Në rastin konkret veprimtarisë së denoncuar i ka munguar karakteri publik, që është kushti që ndan lejimin nga ndalimi i veprimtarisë.

Referuar nenit 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, pika 1.3, shkronja “ç”, e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

Pika 2, e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, parashikon 3 kushte komulative, që të kemi përdorim të burimeve publike. Përkatësisht, ky nen parashikon “përdorim të detyruar të administratës”, “brenda orarit të punës” dhe “për qëllime zgjedhore”. Për aq kohë sa nuk vërtetohet qëllimi zgjedhor dhe përdorimi i detyruar në këto veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e ASHK, dega Sarandë, nuk



përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dega Sarandë, për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

